



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1077/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtine Shkëlqim Selmani nga Subjekti Politik Levizja Vetëvendosje, me seli në Prishtine, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr1077/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtine Shkëlqim Selmani nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtine, me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin 1901E, 1902E, 1915E, 1912E, 1913E, 1924E, 1925E, 1911E.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtine Shkëlqim Selmani nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtine, në të cilën kërkon rinumërimin e votave në vendvotimin 1901E, 1902E, 1915E, 1912E, 1913E, 1924E, 1925E, 1911E, duke u bazuar në pohimet e familjarëve, miqve dhe përkrahësve në këto vendvotime kame mungesë të madhe të votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtine Shkëlqim Selmani nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtine, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimin 1901E, 1902E, 1915E, 1912E, 1913E, 1924E, 1925E, 1911E.

Paneli, vlerëson se parashtresuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për

kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.1077/2021 më datën 06.11.2021**

**Kryesues i Panelit**  
**Ferki Xhaferi**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.